

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, me Gjyqtarin e vetëm gjykues Mustaf Tahiri dhe sekretaren juridike Drita Ujupi, në çështjen penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP.II.nr. 683-3/17 e datës 4 maj 2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik me datë 10.01.2018, në praninë e përfaqësuesit të aktakuzës – Prokurorit të Shtetit Mimoza Sylja, të pandehurit [REDAKTUAR], përfa.të dëmtuarës [REDAKTUAR], të njëjtën datë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 23.01.2018, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri [REDAKTUAR], nga [REDAKTUAR] rr'' [REDAKTUAR]'' nr [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR], e gjinisë [REDAKTUAR], i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr.personal [REDAKTUAR]

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datën 28 janar 2017, në Ferizaj, rruga '' Abdyl Dura'', punëtorët e autorizuar të KEDS-it me rastin e kontrollit të njehsorit elektrik kanë vërejtur se energjia elektrike është duke u devijuar, në atë mënyrë që konsumatori ka bërë ndërhyrje të paautorizuar duke u kyçur me një kabëll në një prizë jashtë pikës matëse, për pasojë energjia e shpenzuar nuk është regjistruar, me ç'rast KEDS-it i ka shkaktuar dëm material në vlerë rreth 371.55 € ,-

me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së,

Andaj Gjykata në bazë nenit 320 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42,49, 51, 64, 73, 75, 76 të KPRK-ës, dhe nenit 365 të KPPK-ës, e

G J Y K O N

DËNIM BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 3 /TRE/ MUAJ dhe DËNIM ME GJOBË NË SHUMË PREJ 200/DYQIND/€, dënime të cilat nuk do të ekzekutohen nëse i akuzuari në periudhën prej 1/NJË/VITI pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen veprë tjetër penale.

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS- distrikti në Ferizaj t'i paguaj shumën në vlerë prej 371.55,€ (treqind e shtatëdhjetë e një euro e pesëdhjetë e pesë cent) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20/njëzet/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën e evidentuar PP.II.nr. 683-3/17 e datës 4 maj 2017, ka ngarkuar të pandehurin [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 10.01.2018, në të cilën shqyrtim fillestar i pandehuri ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon akuza, duke shprehur pendimin për veprën penale të kryer, deklaroi se ka qenë i detyruar pasi nuk ka pasur tjetër mundësi, vuan nga sëmundja shëndetësore e zemrës dhe diabetit, po ashtu deklaroi se ka pasur edhe intervenim kirurgjik në zemër dhe i premtonte gjykatës që më nuk do ta përsëris veprën penale.

Prokurori me rastin e paraqitjes së mendimit të tij, ka propozuar që të pranohet pranimi i fajësisë për të akuzuarin pasi që një pranim i tillë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit dhe të njëjtin ta shpall fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë me ligj.

Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë shqyrtoi me kujdes kushtet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPP-së dhe me këtë rast vlerësoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit siq fatura DFE17HP13221 dt.31.03.2017, procesverbali nr.2238180 si dhe fotografitë të cilat gjenden ne shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje të qartë ligjore apo faktike.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj Gjykata, konform neni 248 par. 4 të KPP-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sikurse me datë, vend dhe kohë siç është përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 75 dhe 76 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari ka pranuar fajësinë, deri më tani nuk është dënuar me aktgjykim të formës së prerë, i gjendjes së dobët ekonomike, me probleme shëndetësore kurse në rastin konkret nuk gjeti rrethanë rënduese pos që vlerësoi peshën konkrete të veprës penale.

Gjykata është e bindur se edhe me dënimin e caktuar, duke marrë parasysh edhe faktin se i akuzuari ka bërë pranimin e fajësisë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në neni 41 të KPK-ës përkatësisht dënimin i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm dhe në përshatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës KEDS- distrikti në Ferizaj t'i paguaj shumën në vlerë prej 371.55,€ (treqind e shtatëdhjetë e një euro e pesëdhjetë e pesë cent) €, në emër të dëmit të shkaktuar, nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPP-ës, obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 20/njëzet/€, i cili obligohet që ti paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, prej ditës kur aktgjykimi merr formën e prerë.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-
DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PENAL,
P.nr. 1069/17 datë 23.01.2018.**

Sekretare juridike,

Drita Ujupi

Gjyqtari individual,

Mustaf Tahiri



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.